



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**  
**Nr. 297, datë 18.11.2013**

**“Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |   |         |             |            |
|---|---------|-------------|------------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar    |
| • | Rezana  | KONOMI      | Zv/Kryetar |
| • | Servete | GRUDA       | Anëtar     |
| • | Koço    | BROKA       | Anëtar     |
| • | Iva     | ZAJMI       | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 18.11.2013, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi një praktikë të mundshme (marrëveshje/praktikë e bashkërenduar) në sektorin e sigurimeve të detyrueshme për sigurimet motorrike të përgjegjësive ndaj palëve të treta”

**Baza ligjore:** Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12/3 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit** të informacionit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi një praktikë të mundshme (marrëveshje/praktikë e bashkërenduar) në sektorin e sigurimeve të detyrueshme për sigurimet motorrike të përgjegjësive ndaj palëve të treta”.

**VËREN SE :**

Bazuar në disa sinjale të marra nga operatorët e tregut të sigurimeve, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës me kërkesën e Komisionit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në datat 14 dhe 15 nëntor 2013, ka monitoruar tregëtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorrik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i kushteve të tregimit të këtij produkti nëse plotësoheshin kushtet për funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Në këndvështrimin e Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" pista kryesore e dyshimit për kufizim të konkurrencës është vlerësuar sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1, shkronjat a dhe c, respektivisht të caktimit të çmimit dhe ndarjes së tregut.

Duke patur parasysh karakteristikat e produktit përkatës dhe rregullimin e këtij tregu të dhënat nga monitorimi tregojnë që çmimet e aplikuara nuk janë të caktuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë dhe nuk janë të njëjta për kompani të ndryshme.

Nga monitorimi rezultoi se nga data 1 Nëntor 2013 të gjithë agjentët e shitjes i tregtonin këto polica nëpërmjet një sistem që quhej MSHM dhe menaxhohej nga një broker. Të dhënat e sistemit të një agjenti në një moment të caktuar nuk të ofronin të gjitha kompanitë e licensuara për tregtimin e produktit përkatës, por një numër më të kufizuar, mesatarisht 4-5 shoqëri. Ndërkohë që nuk është e qartë numri dhe mënyra e shfaqjes së kompanive të disponueshme për lëshimin e policave të sigurimit, pasi në një tjetër agjent, sipas deklarimeve të tij, shfaqeshin të gjitha shoqëritë e sigurimeve.

Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të mjeteve motorrike, në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 42, pika 1 të ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar,

#### **V E N D O S I:**

- I. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun policës së sigurimit për mjetet e transportit për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga 01.11.2013 deri në përfundimin e procedurave hetimore.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 02.12.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**  
(                    )  
**Anëtar**

**Koço Broka**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Rezana Konomi**  
(                    )  
**Zv/Kryetar**

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R**